VENDIM
Nr. 58, datë 10.3.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GRABOVA HYDROPOWER" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "GRABOVA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 14.9 mw

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 20/6 prot., datë 6.3.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Grabova Hydropower' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim:

- Shoqëria "Grabova Hydropower" sh.p.k., më datë 20.12.2024, dorëzoi në ERE kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Grabova 1", me kapacitet të instaluar 14.9 mw.

2. Fillimi i procedurës së licencimit:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 6.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari;

- Në datat 7.1.2025–8.1.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit;

- Deri më datë 5.2.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

3. Kërkesa për dokumentacionin plotësues:

- Me shkresën nr. 20/1 prot., datë 8.1.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 5/2025 dhe i kërkoi informacion/dokumentacion të munguar për aplikimin;

- Me shkresën nr. 20/2 prot., datë 9.1.2025, ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës, duke kërkuar qëndrimin e saj mbi vlefshmërinë e kontratave dhe të drejtat e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimit gjenerues. Deri në këtë vendimmarrje, nuk ka përgjigje nga MIE.

4. Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues:

- Shoqëria dërgoi dokumentacion plotësues me shkresën nr. 20/3 prot., datë 23.1.2025, por pas shqyrtimit u konstatua se ende mungon dokumentacion mbi mbështetjen financiare;

- Për sa konstatuar si më sipër, ERE ju drejtua shoqërisë me shkresën nr. 20/4 prot., datë 12.2.2025, duke kërkuar plotësimin e këtij dokumentacioni;

- Shoqëria dorëzoi dokumentacionin plotësues me shkresën nr. 20/5 prot., datë 20.2.2025.

5. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore:

Në kuadër të aplikimit fillestar dhe dokumentacionit plotësues të dërguar nga shoqëria rezulton se:

- Shoqëria disponon një VNM të vlefshme deri më 20.4.2025;

- Është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit, çështje që ndikon edhe në fillimin e punimeve për ndërtimin e hidrocentralit;

- Për këtë arsye, vlerësohet e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore me shoqërinë për të sqaruar afatet e vlefshmërisë së VNM-së aktuale dhe nevojën për pajisjen me një VNM të re, dhe fazën në të cilën ndodhet shoqëria për marrjen e lejes së ndërtimit të zbardhur.

6. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të rregullores, Bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimmarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë;

- Për këtë arsye, vlerësohet e nevojshme zgjatja deri në 30 ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Grabova Hydropower" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Grabova Hydropower" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Grabova Hydropower" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti